



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1053 Prot.

Tiranë, më 3/10 2016

**REKOMANDIM**

Nr. 20 datë 3/10 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", Zyra e Komisionerit ka kryer hetime administrative në ngarkim të kontrolluesve të arsimit parauniversitar publik, me aktivitetin e tyre në formën ligjore persona juridikë, pas përfundimit të të cilave,

**KONSTATOVA:**

Në zbatim të urdhrave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dala për realizimin e këtyre hetimeve administrative, grupet e inspektimit ushtruan procedurat e hetimit administrativ, në institucionet e arsimit parauniversitar publik, me objekt kontrolli:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesve, (institucionet e arsimit parauniversitar) i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri gjatë kryerjes së aktivitetit të tij, në lidhje me masat për sigurinë e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27 të ligjit.

Kontrolluesit publik apo dhe ata privatë, në raport me ligjin për mbrojtjen e të dhënave janë kontrollues, të cilët mbledhin, ruajnë dhe përpunojnë një gamë të gjerë të dhënash personale, duke filluar nga ato të dhëna që në dukje janë të thjeshta, si gjeneralitetet e nxënësve, mësuesve, adresa apo numra telefoni e deri te ato sensitive, përhapja e të cilave shpesh ka pasoja të rënda për individin.

Shmangia e keqpërdorimit të të dhënave personale të individëve, qoftë dhe nga mosnjohja e ligjit, e qëllimshme apo jo, prej punonjësve të cilët aksesojnë këto të dhëna gjatë ushtrimit të detyrës në institucionet e arsimit parauniversitar, është një detyrë e rëndësishme që duhet zbatuar me rigorozitet nga çdo kontrollues, shtetëror apo privat qoftë ai.

Zyra e Komisionerit zhvilloi procedura hetimore administrative në 13 Drejtoritë Arsimore Rajonale në vend, si dhe në institucione varësie prej tyre. Subjektet e kontrolluara janë:

Drejtoria Arsimore Rajonale Lezhë, Drejtoria Arsimore Rajonale Berat, Drejtoria Arsimore Rajonale Kukës, Drejtoria Arsimore Rajonale Korçë, Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, Drejtoria Arsimore Rajonale Fier, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, Drejtoria Arsimore Rajonale Gjirokastër, Drejtoria Arsimore Rajonale Elbasan, Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër, Drejtoria Arsimore Rajonale Dibër, Drejtoria Arsimore Rajonale Qark Tiranë, Drejtoria Arsimore Rajonale Qytet Tiranë, si dhe Zyra Arsimore apo shkolla në varësi të D.A.R-ve përkatëse.

Procedurat hetimore administrative, janë kryer në ambientet e kontrolluesve, ku në të gjitha rastet, nga ana e grupit të kontrollit është marrë takim me drejtuesit e institucioneve arsimore, personelin ndihmës apo personat e ngarkuar për këtë qëllim, janë mbajtur në vend akt-konstatimet e nevojshme si dhe është nënshkruar në çdo rast procesverbali i hetimit administrativ, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion subjektit të kontrolluar.

Nga këto hetime administrative, u konstatuan një sërë shkeljesh dhe mangësish, problematikat e të cilave po i rendisim si më poshtë vijon:

1- Institucionet arsimore, duke përfshirë dhe shkollat speciale në kuptim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave, janë kontrollues. Këta kontrollues, në kontratat me punonjësit e sistemit arsimor nuk kishin parashikuar detyrimet që ka punëmarrësi në kuptim të ruajtjes së konfidencialitetit.

Deklarata e Konfidencialitetit, e parashikuar në aktin nënligjor të Komisionerit, Vendimi Nr.6, datë 05.08.2013, si dhe në Udhëzimin Nr.12, datë 27.04.2015 i MAS-it, është një akt parandalues për çdo rast të keqpërdorimit të të dhënave personale të subjekteve, nxënës dhe mësues, (neni 28 i ligjit).

2-Në shumicën e rasteve, institucionet arsimore duke përfshirë dhe shkollat speciale të cilat trajtojnë nxënësit me aftësi të kufizuara, nuk dispononin rregullore të mbrojtjes së të dhënave personale, madje dhe kur e dispononin një të tillë ajo ishte fiktive, pasi detyrimet që burojnë nga ajo rregullore nuk ishin përmbushur (neni 27 i ligjit).

3-Konstatohet se dosjet personale të krijuara nga psikologët e shkollave dhe mësuesve ruhen edhe pasi ka mbaruar qëllimi për të cilin janë mbledhur të dhënat sensitive të nxënësve. Sipas psikologëve apo punonjësve socialë të intervistuar nga grupet e inspektimit koha e ruajtjes së të dhënave nuk është e përcaktuar në rregullore apo udhëzime specifike.

4-Në disa shkolla të mesme të përgjithshme, aplikohet mbikëqyrja e ambienteve nëpërmjet sistemit të kamerave, për të cilat subjektet e të dhënave nuk informoheshin, sipas detyrimit të shprehur në nenin 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

5-Në disa institucione të arsimit parauniversitar nuk kishin dijeni për Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe për pasojë nuk kishin përmbushur detyrimin fillestar për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit, (neni 21 dhe 22 i ligjit).

6-Konstatohet se të gjitha D.A.R./Z.A-të në vend administrojnë vetëm një adresë zyrtare respektive të postës elektronike (e-Mail), dhe të gjithë punëmarrësit komunikojnë nëpërmjet postës elektronike personale ndërmjet njëri-tjetrit, apo dhe me homologët e tyre nëpër rrethe. Kjo përbën shkelje, jo vetëm në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, por dhe për vetë sistemin arsimor në tërësi, pasi komunikimi administrativ zyrtar i kryer nëpërmjet postës elektronike personale të punonjësve, i heq të drejtat kontrolluesit mbi këtë komunikim. Adresa e postës elektronike mundësohet nga M.A.S.

7-Pranë burimeve njerëzore të institucioneve arsimore parauniversitare, u konstatuan dosje të personelit që datojnë para viteve 1991, të cilat mbartin të dhëna sensitive mbi bindjet politike. Këto dosje përmbajnë të dhëna në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Udhëzimin Nr.12, datë 17.04.2015 të M.A.S-it, pika 6 gërma "c".

8-Në shumicën e portaleve të D.A.R-ve apo Z.A-ve në vend, publikohet numri i identitetit të aplikantëve. Parë në këndvështrimin e Zyrës së Komisionerit, publikimi i numrit të identitetit të aplikantit, në faqen e D.A.R-it apo Z.A-së është i tepërt dhe çënon privatësinë e mësuesve aplikantë.

Udhëzimi Nr.38, datë 06.10.2015, po i M.A.S-it, saktëson dhe detyron sipas pikës 5, Kreu 2, si vijon: *"...Renditja bëhet publike nëpërmjet faqes zyrtare të njesisë arsimore vendore, ku kandidatët identifikohen me kod personal.."*

9-Pranë Zyrës së Komisionerit, paraqiten ankues të shumtë të cilëve nuk u jepet e drejta e pajisjes nga institucionet arsimore me Dëftesat e Pjekurisë, në rastet kur nuk e disponojnë atë. Vërtetimet e lëshuara nga institucionet arsimore, sipas Urdhrit Nr.76, datë 19.02.2013 *"Për legalizimin e dokumenteve zyrtare të arsimit parauniversitar në M.A.SH."*, në shumicën e rasteve nuk pranohen nga institucionet brenda dhe jashtë vendit ku shtetasi aplikon për punësim apo shkollim. Shtetasve, si subjekte të të dhënave personale, u hiqet e drejta për të poseduar Dëftesën e Pjekurisë (investim ky në vite i individit), kur ai mund të pajiset me kartë identiteti, pasaportë, certifikatë pronësie, me dëshmi penaliteti etj, sa herë e ka të nevojshme. Në këndvështrimin e Komisionerit, mospajisja e individit me Dëftesat e Pjekurisë, në rastet kur ai për arsye objektive apo subjektive nuk e posedon atë, për pasojë kufizon të drejtat e individit për shkollim, punësim etj. Gjithashtu, konstatohet se, nga ana e drejtorive të shkollave të mesme të përgjithshme, mbahen dëftesat e shkollës 9-vjeçare, për një afat kohor 1- vjeçar, kur ky veprim nuk është as i ligjruar.

Zyra e Komisionerit çmon se është një praktikë ilegjitime, në dëm të subjektit të të dhënave. Në përmbushje të detyrave funksionale që institucionet arsimore parauniversitare duhet të realizojnë, shkollat të mbajnë dëftesat e nxënësve, të fotokopjuara nga origjinali që nxënësi e paraqet kur kryen regjistrimin, duke ja kthyer dëftesën origjinale poseduesit

Të gjitha D.A.R-et në vend, apo Zyrat Arsimore Vendore kanë detyrimin e përmbushjes së konstatimeve të mësipërme, në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, akteve të miratuara nga Komisioneri, por dhe në përputhje me Udhëzimin Nr.12 i M.A.S-it, Kreu IV, Dispozitat e Fundit, ku shprehimisht citohet:

*"1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare."*

Zyra e Komisionerit konstaton se, ka mungesë informacioni nga ana e institucioneve të arsimit parauniversitar mbi Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, e për pasojë dhe e punëmarrësve të këtyre institucioneve.

Do të ishte në dobi të palëve, kontrollues, subjekt i të dhënave dhe përpunues, të kryheshin trajnime të hcrëpas-hershme, rreth mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, konform nenit 87-89 të Ligjit Nr. Nr.44/2015, datë 30.04.2015, *"Kodi i Procedurave Administrative"*, ka realizuar seanca dëgjimore në lidhje me të drejtën e palëve për tu dëgjuar, ku kontrolluesit më së shumti shprehën gatishmërinë për të rikuperuar gjetjet e konstatuara nga grupet e inspektimit në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale.

Zyra e Komisionerit, në përputhje me Ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, si dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, pasi ndoqi me vëmendje ecurinë e procedurës së hetimeve administrative dhe, pretendimet e përfaqësuesve të institucioneve të arsimit parauniversitar të shprehura në seancat dëgjimore, konkludoi nëpërmjet akteve të vendim marrjes së Komisionerit, për të cilat në çdo rast ju jeni vënë në dijeni.

Zyra e Komisionerit vlerëson faktin që kontrolluesit e institucioneve arsimore të sistemit parauniversitar, gjatë kontrolleve nga grupet e hetimit administrativ kanë qenë bashkëpunues, dhe reagues në lidhje me zbatimin e Ligjit *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*.

Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"*, i ndryshuar dhe në kuadër të problematikave të hasura në institucionet arsimore të sistemit parauniversitar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e institucionit epror, në zbatim të neneve 5 dhe 6 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, pikës 6 gërma "c" dhe shtojcës 2/1 të Udhëzimit Nr.12 datë 17.04.2015 të MAS-it, të marrë masat për të asgjësuar në afatin ligjor, të dhënat sensitive shëndetësore/mendimet politike, për nxënësit dhe mësuesit.
2. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e institucionit epror, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të marrë masat për të realizuar detyrimin e informimit të subjekteve të të dhënave, në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar.
3. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar, të marrë masat për të realizuar detyrimin e përditësimit të njohimit, për të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar.

4. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat mbi pajisjen me rregullore të mbrojtjes së të dhënave personale, për të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar, duke patur një kujdes të veçantë për shkollat speciale.
5. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Udhëzimit Nr.12 datë 17.04.2015 të MAS-it, të marrë masat për të realizuar Deklaratat e Konfidencialitetit, për të gjithë punonjësit e institucioneve arsimore, të cilët aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës në këto institucione.
6. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, në cilësinë e poseduesit publik zyrtar mbi gjithë aktivitetin në sistemin arsimor, të parashikojë mundësinë e pajisjes me adresa zyrtare për postën elektronike të punonjësve, apo pajisjen e çdo departamenti të institucioneve arsimore me adresë zyrtare të postës elektronike.
7. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, në mbështetje të të drejtave themelore të individit, të rishikojë mundësinë e hartimit të një akti ligjor, mbi pajisjen e shtetasve me Dëftesa Pjekurie, dhe të orientojë institucionet e arsimit parauniversitar të mos kthejnë në praktikë pune, mbajtjen e dëftesave origjinale, por fotokopjen e këtij dokumenti.
8. Kontrolluesi Ministria e Arsimit dhe Sportit, duhet të realizojë detyrimet rekomanduese të këtij akti, brenda një afati kohor prej 6 muajve nga dalja e tij.
9. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 3 .10 .2016

